

Thirrja nga data 05.01.2024 deri me 15.01.2024

TERMAT E REFERENCES

KOMPANI DIZAJNUESE PËR REALIZIMIN E MATERIALEVE PROMOVUESE TË PROJEKTEVE TË IMPLEMETUARA NGA OJQ “NEVO KONCEPTI”

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimin e kampanisë.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI”
Objektiva	Dizajnimi, përgatitja dhe shtypja e materialeve promovuese

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 4 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Përgatitja e broshurave, për projektet të cilat i implementon Nevo Koncepti, broshurat duhet të jenë në gjuhën sipas kërkesës.
- Përgatitja e mirënjohjeve.
- Përgatitja e posterave.
- Përgatitja e bannerit.
- Përgatitja e billboardit.
- Vizit kartelat.
- Organizimi i kampanjës.
- Përcjellja e të gjitha materialeve në formë elektronike, në CD apo USB.

2. AFATI KOHOR

Përgatitja e materialeve promovuese do të bëhet sipas planit të veprimit të paraparë në projektet e OJQ “Nevo Koncepti”

3. REZULTATET E PRITSHME

- Dizajnimi dhe përfundimi i materialeve promovuese në kohën e caktuar.
- Dizajnimi, përgatitja dhe shtypja e materialeve promovuese të jenë me qmime të njëjta gjatë periudhës së kontratës.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen duke përfshirë këto dokumente:

- Oferta
- Kopja e regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 15.01.2024**

Blerim Gashi b.gashi@nevokoncepti.org duke e shtuar në CC Drejtorin Ekzekutiv të Nevo Konceptit z.Osman Osmani, o.osmani@nevokoncepti.org ose ti sjellin në mënyrë fizike në zyrën e Nevo Konceptit: **Rr.Adnan Krasniqi nr.49, hyrja II nr.8**